



PLANI I INTEGRITETIT PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT

2022–2025

Miratuar me Urdhrin nr.158, datë 26.04.2022 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

1. Athanas Karaja
2. Ergis Tafalla
3. Redi Baduni
4. Artenida Duraku
5. Klodianë Marika
6. Alma Baze
7. Trajan Vasili
8. Inxhi Buzi
9. Enerieta Tarelli
10. Rovena Moçka
11. Enkelana Shala
12. Edlira Dersha



Institute for Democracy and Mediation
Institut për Demokraci dhe Ndërmarrje



Eksperjtë e IDM:

Evelina Azizaj, Eksperte për Etikën dhe Integritetin
Erald Bezhani, Ekspert i Menaxhimit të Riskut

Plani i Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është hartuar në kuadër të Projektit “Përmirësimi i integritetit të institucioneve publike të qeverisjes qendrore nëpërmjet zgjerimit të Planeve të Integritetit” të mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e UNDP-së në Shqipëri.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	3
LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE.....	4
Hyrje.....	5
1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit	5
1.1.1 Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore në nivel institucional ...	6
1.1.2 Identifikimi i risqeve dhe faktorëve të riskut të integritetit	6
1.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit	6
1.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut.....	7
1.2. Qasja metodologjike.....	7
3. Plani i Veprimit.....	11
4. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të Planit të Veprimit	12
5. Matrica e Planit të Veprimit.....	13
Objektivi 1: Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjesdis, përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë.....	13
Objektivi 2: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga MTM-ja.	17
Objektivi 3: Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregulator me rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për forcimin e etikës dhe integritetit në institucion.....	23
Objektivi 4: Rritje e besueshmërisë publike të institucionit përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënieve institucionale si dhe politikëbërjes me pjesëmarrje të mjesdit dhe turizmit	27
Objektivi 5: Forcimi i rezistencës institucionale për procese/funksione me risk për cenimin e integritetit, nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave dhe masave të kontrollit në procesin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të politikave dhe projekteve në fushën e mjesdit dhe turizmit.	33

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AMVV	Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare për Administratën Publike
DDLLM	Drejtoria e Derregullimit të Lejeve dhe Licensave dhe Monitorimit
DIKMA	Drejtoria e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës
DKFPM	Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Mjedis
DKFPT	Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Turizëm
DMBNJASH	Drejtoria e Miradiministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve
DPP	Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve
DPSZHM	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit
DPSZHM	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit
DPSZHT	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit në Turizëm
DPSHKRr	Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregulator
GPI	Grupi i Punës për Integritet
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
KDI	Koordinatori për të Drejtën e Informimit
KNJKP	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MVRI	Metodologja e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore
NJVV	Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore
PI	Plani i Integritetit
PT	Programi i Transparencës
RKP	Registri i Kërkesave dhe Përgjigjeve
SPIS	Sektori i Përpunimit të Informacionit dhe Statistikave

Hyrje

Dokumenti i Planit të Integritetit (PI) për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) përfaqëson përpjekjen institucionale për të prezantuar dhe vendosur një sistem efektiv të menaxhimit të integritetit për periudhën kohore 2022-2025. PI-ja shërben si instrument efektiv për luftën antikorrupsion në nivelin e institucionit duke identifikuar, vlerësuar dhe adresuar risqet që cenojnë integritetin në proceset kryesore të punës së institucionit. Përgatitja e dokumentit të PI-së bazohet mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut që lidhen me aspektet e etikës dhe integritetit (transparencë, llogaridhënia, efektiviteti, eficenza, pjesëmarrja qytetare etj) në proceset e punës të institucionit sipas fushave kryesore të përgjegjësisë. Në këtë mënyrë, procesi i planifikimit për forcimin e etikës dhe integritetit institucional nuk përbën një proces të veçuar, por një pjesë integrale të menaxhimit dhe funksionimit të përgjithshëm të institucionit.

Vlerësimi i risqeve të integritetit për proceset dhe nënproseset e punës në MTM u realizua sipas fushave të përgjegjësisë së Ministrisë, të cilat përfshijnë si më poshtë:

- i) Miradiminimi i burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve;
- ii) menaxhimi financiar;
- iii) kontrolli, auditimi dhe mekanizmat kundër korruptionit;
- iv) transparenca dhe konsultimi publik;
- v) prokurimet dhe partneritetet;
- vi) programimi, standardizimi dhe harmonizimi i kuadrit rregullator;
- vii) integrimi, koordinimi, marrëveshjet dhe asistanca;
- viii) politikat dhe strategjite e zhvillimit të mjedisit;
- ix) programet e zhvillimit të mjedisit duke përfshirë cilësinë dhe pastërtinë e mjedisit; mbrojtjen mjedisore dhe biodiversitetin, pyjet dhe kullotat;
- x) konceptimi dhe fizibiliteti i projekteve të mjedisit;
- xi) derregullimi i lejeve, licensave dhe monitorimit;
- xii) politikat dhe strategjite e zhvillimit të turizmit;
- xiii) programet e zhvillimit në fushën e turizmit;
- xiv) konceptimi dhe fizibiliteti i projekteve të turizmit.

Plani i Integritetit për MTM-në është përgatitur me pjesëmarrjen e gjithë stafit të Ministrisë të angazhuar në nivele të ndryshme organizative dhe udhëhequr nga Grupi i Punës për Integritet (GPI) si dhe me asistencën teknike të Institututit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Dokumenti është produkt i një procesi gjithëpërfshirës, i planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të riskut në zbatim të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore.¹

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit për MTM-në u zhvillua në harkun kohor të katër muajve duke filluar në muajin janar 2022. Dokumenti final i Planit të Integritetit u miratua nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit më 26.04.2022

¹ Urdhër i Ministrit të Drejtësisë, Nr.334, datë 07.10.2020 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet qendrore"

Në përputhje me Udhëzimet e MVRI-së, procesi i planifikimit të integritetit kaloi në hapat e mëposhtëm:

1.1.1 Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore në nivel institucional

Me urdhër të Ministrit nr. 158, datë 16.07.2021 “Për Hartimin e Planit të Integritetit”, i ndryshuar u ngriti Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit për MTM-në. GPI-ja përbëhet nga 12 anëtarë dhe një koordinator për të udhëhequr procesin e planifikimit, kryesisht përmes koordinimit ndërmjet strukturave të ndryshme në institucion dhe mobilizimit të stafit, të angazhuar në nivele të ndryshme organizative.

Më 25 janar 2022, ekipi i IDM-së zhvilloi një sesion trajnimi me anëtarët e GPI-së për të prezantuar procesin, qasjen metodologjike të planifikimit për integritet, si dhe duke përfshirë objektivat, fazat e procesit, instrumentet dhe produket përkatëse. Trajnimi shërbeu edhe si një mundësi diskutimi rreth pritshmërive të projektit dhe aspekteve të ndryshme të procesit.

Më tej, GPI-ja komunikoi dhe informoi stafin e Ministrisë, të angazhuar në të gjitha nivelet dhe proceset e punës, mbi procesin e planifikimit të integritetit në institucion.

1.1.2 Identifikimi i risqeve dhe faktorëve të riskut të integritetit

Grupi i punës i asistuar nga ekipi i IDM-së u fokusua në identifikimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të riskut që përfshijnë burimet, ndikimin dhe shkaktarët e tyre në proceset kryesore të punës, sipas fushave të përgjegjësisë së MTM-së. Risqet e identifikuara janë të llojeve të ndryshme si për shembull: burime njerëzore, operacionale, financiare, reputacionale dhe imazhi etj, të cilat dobësojnë përpjekjet institucionale në përbushjen e objektivave strategjikë.

Në fazën e identifikimit të risqeve dhe faktorëve të tyre, Grupi i Punës shqyrtoi kornizën e brendshme irregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operacionale të Ministrisë. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca institucionale përmes raporteve të ndryshme, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Në këtë fazë të analizës, u përdorën edhe gjetjet e pyetësorit të vetëvlerësimit të administruar elektronikisht nga stafi i Ministrisë mbi perceptimet dhe përvojat e tyre në lidhje me çështje të etikës dhe integritetit në institucion. GPI-ja analizoi të dhënat nga pyetësori për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, ku 83 punonjës të MTM-së e plotësuan atë.

GPI-ja u përfshi në identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të Ministrisë. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të mbledhura nga 14 diskutimet në grupe të fokusuara me stafin e Ministrisë, të përfshirë në proceset e punës sipas fushave funksionale të institucionit.

1.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit

Gjatë kësaj faze, GPI-ja vlerësoi intensitetin e risqeve të analizuara në fazën e mësipërme, duke identifikuar dhe analizuar edhe faktorët e riskut që mbështesin ose rrisin këto risqe. Kjo fazë përfshin edhe kryerjen e një analize për ato fusha të veprimtarisë që kërkojnë vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë.

Më tej, procesi përfshiu vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara si dhe propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Kjo fazë përfshiu GPI-në dhe u mbështetet kryesisht në diskutimet dhe kontributet e tyre të siguruara përmes diskutimeve në grupet e fokusuara, të cilat gjithashtu u realizuan sipas fushave të përgjegjësisë së Ministrisë.

1.1.3 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

GPI-ja me asistencën teknike të IDM-së hartozi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshin masa të reja kontrolli dhe/ose përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për të mbuluar periudhën kohore 2022-2025. Zbatimi i planit përfshin implikime financiare minimale dhe mbështetet në maksimizimin e punës në të gjitha strukturat dhe nivelet organizative të institucionit. Kostot financiare që gjeneron zbatimi i Planit të masave do të mbulohen nga buxheti i MTM-së.

1.2. Qasja metodologjike

Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, përcakton qasjen metodologjike të procesit të planifikimit të integritetit për Ministrinë. Metodologjia përfshin një kombinim të metodave cilësore dhe sasiore për të analizuar dhe vlerësuar cenueshmërinë e integritetit institucional.

Shqyrtimi i literaturës përfshiu:

- Kuadrin e brendshëm rregullator dhe strategjik të MTM-së të tillë si: urdhra, manuale, strategji apo dokumente politikash, rregullore dhe akte të brendshme;
- Raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e MTM-së, si dhe raporte/studime mbi qeverisjen qendrore;
- Analizimi i faqes zyrtare të internetit të MTM-së, programit të transparencës, regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve etj,

Katërmbydhjetë diskutime në grupe të fokusuara me stafin e Ministirsë, të angazhuar në nivele të ndryshme organizative, në tematika që përkojnë me fushat funksionale të Ministrisë të tillë si: i) fusha e miradministrimit të burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve; ii) fusha e menaxhimit financier; iii) kontrolli, auditimi dhe mekanizmat kundër korruptionit; iv) transparenca dhe konsultimit publik; v) prokurimet dhe partneritetet; vi) fusha e programimit, standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregulator; vii) fusha e integrimit, koordinimit, marrëveshjeve dhe asistencës; viii) fusha e politikave dhe strategjive të zhvillimit të mjedisit; ix) programet e zhvillimit të Mjedisit duke përfshirë cilësinë dhe pastërtinë e mjedisit; mbrojtjes mjedisore dhe biodiversitetin, pyjet dhe kullotat; x) fusha e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të mjedisit;

xii) fusha e derregulimit të lejeve, licensave dhe monitorimit; xiii) fusha e politikave dhe strategjive të zhvillimit të turizmit; xiv) fusha e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të turizmit; xv) fusha e programeve të zhvillimit në fushën e turizmit.

GPI me asistencën e IDM-së analizoi të dhënat e grumbulluara nga diskutimet për të identifikuar ngjarje negative në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe funksione të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjellje joetike e joprofesionale, si dhe parregullsi të tjera.

Pyetësori i vetëvlerësimit, i strukturuar dhe administruar elektronikisht nga stafi i bashkisë mbi vetëvlerësimin e çështjeve të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Pyetësori është një instrument efektiv për mbledhjen e të dhënavët kuantifikuara të risqeve të integritetit për aspekte të veçanta të integritetit në institucion. Anketimi përfshiu një kampion prej 92 punonjësish të institucionit (nga të cilët reaguan 83) me një nivel besueshmërie statistikore 95%. Shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 5%. Kampioni përfshiu një shpërndarje të gjërë në lidhje me gjininë, moshën dhe vjetërsinë në punë. Të anketuarit femra dominojnë kampionimin duke përfaqësuar 69% të tij. Punonjësit e moshës 26-45 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion duke përfaqësuar 60% te tij, ndërsa grup-mosha 46-55 vjeç zë 21% të kampionit. Kategoria e grup-moshës mbi 56 vjeç përfaqësojnë 15.7 % të kampionit. Më pak e përfaqësuar është grup-mosha e re deri në 25 vjeç, e cila përfaqëson 4% të kampionimit.

Përsa i përket përvojës së punës, kategoria me vjetërsi pune nga 5 deri 10 vjet, 21-31 vjet dhe 11-20 vjet, përbëjnë pjesën më të madhe të kampionionit dhe me diferençë të vogël ndërmjet tyre, përkatesisht 29%, 28% dhe 23% e kampionimit. Kategoria me më shumë se 55 vjet punë dhe më pak se 5 vite pune, përfaqësojnë përqindjen më të vogël të kampionimit, përkatesisht 2% dhe 18%.

2. Objektivat e identikuara dhe niveli i përgjithshëm i cenesshmërisë së integritetit
Qëllimi kryesor i PI-së për Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, është vendosja e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit, llogaridhënieve dhe transparencës publike për të forcuar integritetin institucional dhe përmirësuar standarde profesionale, përmes ndërtimit të proceseve të punës bazuar në analizën e riskut. Kjo do të mundësojë adresimin e kërcënimeve për shkelje të integritetit duke përmirësuar rezistencën ndaj shkeljeve të ligjit, ndaj korruptionit, si dhe në të njëjtën kohë përmirësimin e standardeve profesionale dhe performancën institucionale.

Gjithashtu, PI-ja do të orientohet drejt rritjes së transparencës, llogaridhënieve dhe pjesëmarrijes së publikut në politikëbërjen mjedisore dhe në turizëm, duke përmirësuar ndërveprimin dhe besimin e publikut drejt MTM-së.

Objektivat e planit synojnë të hedhin hapat e parë në zhvillimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në MTM, duke fuqizuar aspekte të punës që përmirësojnë integritetin dhe forcojnë rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Qëllimi i PI-së do të arrihet përmes objektivave të planit, të cilat janë si më poshtë:

Objektivi 1	Objektivi 2	Objektivi 3	Objektivi 4	Objektivi 5
Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjedis. Përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë.	Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre, për të përmirësuar standarde shërbimeve të ofruara nga MTM-ja.	Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullaror me rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për forcimin e etikës dhe integritetit në institucion.	Rritje e besueshmërisë publike të institucionit përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënieve institucionale, si dhe politikëbërjes, me pjesëmarrje të mjedisit dhe turizmit.	Forcimi i rezistencës institucionale për procese/funksione me risk për cenimin e integritetit nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave dhe masave të kontrollit në procesin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të politikave dhe projekteve në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Objektivi 1: Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjedis, përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë

Objektivi i parë synon të adresojë risqet dhe faktorët e riskut, të identikuara në procesin politikëbërës të Ministrisë në të dyja fushat, mjedis dhe turizëm, Risqet e identikuara në funksionin politikëbërës të Ministrisë në mjedis dhe turizëm, lidhen me efektivitetin dhe efikasitetin e këtyre proceseve, si rrjedhim i qasjes strukturore të institucionit. Struktura organizative aktuale e MTM-së është ngritur në përputhje me urdhrrin nr. 165, datë 05.10.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”. Modeli strukturor i Ministrisë - një model horizontal - nuk vlerësohet efektiv dhe eficent. Risqet e identikuara si pasojë e strukturimit institucional në politika, programe dhe projekte përmblidhen si më poshtë:

- Struktura organizative institucionale është joefektive duke mos reflektuar të gjitha kompetencat e Ministrisë, veçanërisht ato mjedisore.
- Ndarje e paqartë e funksioneve, proceseve të punës dhe detyrave të drejtoreve të ndryshme, duke shkaktuar mbivendosje të tyre dhe konfuzion në kryerjen e detyrave;
- Emërtimet e drejtoreve nuk reflektojnë proceset e punës dhe detyrat që ato realizojnë;
- Mungesa e sektorëve për të gjitha fushat (në mjedis) që Ministria mbulon duke lënë jashtë strukturës organizative sektorë të rëndësishëm;
- Pamjaftueshmëri e stafit të angazhuar në raport me detyrimet për t'u përbushur (detyrimet ligjore) dhe mbingarkesë e burimeve njerëzore për shkak të angazhimit të stafit në disa fusha teknike; mungesa e përgjegjësit të sektorit;
- Struktura aktuale shkakton probleme të ndërveprimit mes drejtoreve të cilat sjellin vonesa në realizimin e proceseve të punës.

Vetëm 21% e të anketuarve pohojnë se procedurat e punës garantojnë një ndarje plotësisht të përshtatshme të detyrave në sektorin/drejtoren tuaj, 29% mjaft të përshtatshme, 35% të përshtatshme, përkundrejt 13% dhe 2% që tregojnë se këto

procedura janë disi të përshtatshme dhe aspak të përshtatshme. Ndërsa vetëm 12% e të anketuarve mohojnë të kenë marrë detyra përtej përshkrimit të punës në dy vitet e fundit.

Objktivi 2: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar, standardet e shërbimeve të ofruara nga MTM-ja.

Objktivi 2 synon të adresojë risqet që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin profesional të tyre, të cilat vështirësojnë përpjekjet e institucionit të realizojë proceset e punës me cilësi dhe ofrmin e shërbimeve me standarde. Vetëm 44% e të anketuarve konfirmojnë se institucioni ka një plan për kualifikimin profesional të punonjësve, 13% mohojnë dhe 44% nuk e dinë nëse institucioni ka një plan të tillë. Ndërsa për sistemin e vlerësimit të performancës në punë 46% e të anketuarve shprehen se vlerësimi është proces formal dhe 43% se sistemi aktual i vlerësimit krijon hapësira për subjektivitet. Menaxhimi i dobët i etikës dhe integritetit është një tjetër risk që buron nga njohja e ulët e stafit të kuadrit të brendshëm rregullator në lidhje me etikën dhe integritetin: 72% tregojnë se nuk janë trajnuar mbi rregullat për mbrojtjen e sinjalizueseve, 41% nuk janë në dijeni të rregullave për mbrojtjen e sinjalizueseve; 46% nuk janë në dijeni të procedurave lidhur me pranimin dhe administrimin e dhuratave, 46% nuk e dinë nëse ka një strukturë/ person në institucion i cili ka për detyrë të monitorojë nëse punonjësit janë në konflikt interesit në kryerjen e një veprimitarje, etj.

Masat e veprimit nën këtë objektiv do të mundësojnë një staf të qëndrueshëm, të kualifikuar dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit. Masat kryesore lidhen me procesin e vlerësimit të performancës, planifikimin e trajnimeve, sistemin e vlerësimit të ndikimit të trajnimeve dhe ndarjen e njohurive të fituara, hartimit të procedurave që dokumentojnë proceset e punës për të rritur cilësinë duke ndjekur një procedurë të standardizuar, dhe zhvillimin profesional të stafit të Ministrisë në tematika relevante me proceset specifike të punës në të cilat janë të angazhuar. Gjithashtu, njohja e stafit në të gjitha nivelet me rregulloret/procedurat në lidhje me etikën dhe integritetin (PI, Kodi Etikës/Sjelljes, Rregullore e Konfliktit të Interesit, Rregullore për Sinjalizimin dhe Mbrotjen e Sinjalizuezve etj) do të jetë hapi i parë drejt promovimit dhe përqafimit të vlerave dhe parimeve të integritetit.

Objktivi 3: Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator me rregulla dhe procedura të qarta e transparente, për forcimin e etikës dhe integritetit në institucion

Objktivi 3 adreson nevojën e institucionit për të patur një kuadër rregullator të plotë në mënyrë që të jetë efektiv duke integruar dispozita të reja ose rifreskuar ato me ndryshimet më të fundit ligjore, kryesisht ato që lidhen me çështje të integritetit të tilla si: Plani i Integritetit, rregulla për garantimin e të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale, njoftimit dhe konsultimit publik. Vetëm 89% e punonjësve të anketuar konfirmojnë se procedurat e punës që ndjekin janë përshkruar dhe dokumentuar me hollësi, përkundrejt 11% që përgjigjen negativisht ose nuk e di.

Të gjitha masat e veprimit nën këtë objektiv do të mundësojnë një kuadër të brendshëm rregullator që është efektiv dhe prezanton procedura dhe rregulla pune që janë të qarta, transparente dhe të dokumentuara, në mënyrë që të mbështetin dhe nxitin integritetin. Me zbatimin e masave të

veprimit, pritet që strukturat institucionale që nxisin integritetin institucional të tilla si; Koordinatori për të Drejtën e Informimit, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin publik, të jenë të mbështetura institucionalisht dhe llogaridhënëse. Për më tepër, masat e veprimit synojnë të përmirësojnë fusha të përgjegjësisë të cilat kanë nevojë për standardizim të procedurave të tyre, duke u ofruar punonjësve informacion për të kryer siç duhet një proces pune duke garantuar cilësinë dhe integritetin e punës dhe rezultateve të saj.

Objktivi 4: Rritje e besueshmërisë publike të institucionit përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënieve institucionale si dhe politikëbërjes me pjesëmarrje të mjedisit dhe turizmit

Objktivi 4 synon të adresojë risqet që lidhen me transparencën dhe llogaridhëni institucionale si dhe sigurimin e politikëbërjes me pjesëmarrje. Duke marrë në konsideratë se Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve përfaqësojnë instrumente efektive për transparencë publike të veprimtarisë së institucionit, plani i masave synon rritjen e transparencës përmes plotësimit të tyre. Gjatë analizës u vu re se Ministria ende nuk ka publikuar shumicën e informacionit që kërkohet të përfshihet në Programin e Transparencës, të bërë publik në faqen zyrtare të internetit. Në faqen zyrtare të internetit të MTM-së publikohen të dhëna dhe informacione me karakter vetëm dhe thjesht informues. Nuk janë të publikuara informacione dhe dokumente që lidhen me mekanizmat monitorues, të kontrollit dhe llogaridhëns, siç mund të janë: raporte të ndryshme monitorimi të kontrollit të brendshëm, kontrata publike, procesverbale, raporti vjetor i transparencës etj. Gjithashtu, mosbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik nuk siguron pjesëmarrjen e publikut në politikëbërjen mjedisore dhe të turizmit.

Objktivi 5: Forcimi i rezistencës institucionale për procese/funksione me risk për cenimin e integritetit nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave dhe masave të kontrollit në procesin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të politikave dhe projekteve në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Objktivi i pestë synon adresimin e risqeve të integritetit në ato procese pune të cilat janë në risk për cenimin e integritetit. Risqet e përfshira janë të karakterit operacional dhe impakti i tyre është i natyrave të ndryshme të tilla si: financiar, strategjik, operacional, reputacional dhe të lidhur me informacionin. Masat e parashikuara synojnë forcimin e proceseve monitoruese të dhënisë së lejeve dhe licensimit, forcimin e monitorimit dhe komunikimit të progresit në zbatimin e strategjive të sektorëve, planeve të veprimit, forcimin e bashkëpunimit dhe partneriteteve me aktorë të tjera, lehtësimin e ndarjes së informacioneve ndërmjet institucioneve etj.

3. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të përbushur objektivat e sipërpërmendura të cilat adresojnë risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuara në fushat kryesore të përgjegjësisë së MTM-së. Plani i Veprimit prezantohet në formë matrice dhe është pjesë integrale

e kuadrit strategjik dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional. (Shiko më poshtë Matrica e Planit të Veprimit).

4. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të Planit të Veprimit

Procesi i planifikimit e lejon MTM-në të monitorojet vazhdimisht zbatimin e planit për të matur nivelin e zbatimit të masave të parashikuara dhe rishikimin në mënyrë periodike të tij. Të dy aktivitetet si monitorimi dhe rishikimi i planit (bazuar në gjetjet e monitorimit) përbëjnë aspekte të rëndësishme të zbatimit të Planit, si për të siguruar efektivitetin e masave, por edhe përshtatjen e planit me ndryshimet dhe zhvillimet e të gjitha natyrave: ligjore, organizative apo procedurale etj.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit do të bëhet në baza vjetore (çdo vit) dhe prezanton kryerjen e aktiviteteve nga ana e strukturave përgjegjëse për zbatimin e masave brenda afatit kohor të përcaktuar. Më tej, monitorimi do të vlerësojë nëse masat e zbatuara kanë qenë eficente, kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetet e risqeve (planit të veprimit). Monitorimi ka rëndësi edhe në aspektin e identifikimit të mësimeve të nxjerra për t'i përdorur në të ardhmen, në funksion të përmirësimit të proceseve planifikuese të integritetit dhe menaxhimit të tij.

Raportimi është një procedurë e rregullt që do të shoqërojë procesin e monitorimit për të ndarë gjetjet me stafin, Kabinetin dhe aktorë të tjera të interesit. Raporti do të adresojë pyetjen: a janë zbatuar masat e parashikuara për risqet e integritetit nga strukturat përgjegjëse sipas afateve kohore të parashikuara? A kanë qenë efektive masat? A ka nevojë për rishikim të risqeve dhe faktorëve të risqeve? Çfarë masash të reja nevojiten të ndërmerren?

Procesi i monitorimit dhe raportimit të planit ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar me urdhër të Ministrit. Frekuencia minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi duhet të bëhet me stafin në të gjitha nivelet organizative si një mënyrë për të vlerësuar arritjet dhe inkurajuar zbatimin më tej të masave.